



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Më 8 shkurt 2024, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miratoi kërkesën e Prokurorisë për të bashkuar çështjen gjyqësore kundër Sabit Januzit dhe Ismet Bahtijarit me çështjen kundër Haxhi Shalës.

Gjykatësi konstatoi se bashkimi i dy çështjeve gjyqësore do t'i shërbejë administrimit të duhur të drejtësisë. Të tre të akuzuarit akuzohen për të njëjtat shkelje të pretenduara (pengim të personave zyrtarë dhe frikësim gjatë procesit penal) bazuar në të njëjtat ngjarje. Konkretisht, të dyja aktakuzat pretendojnë se z. Shala, z. Januzi dhe z. Bahtijari së bashku u bashkërenduan dhe vepruan si grup për të kontaktuar një dëshmitar të mbrojtur me qëllim që ta bindnin të hiqte dorë nga pjesëmarrja në proces para Dhomave të Specializuara të Kosovës. Gjykatësi konstatoi gjithashtu se bashkimi i çështjeve gjyqësore nuk dëmton dhe as nuk është në mospërputhje me të drejtat e të akuzuarve.

Më 9 shkurt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Haxhi Shalës, duke konstatuar se ekziston rrezik i moderuar i arratisjes dhe arsye të artikulueshme për të besuar se z. Shala mund të pengojë ecurinë e procesit të Dhomave të Specializuara, ose të kryejë vepra penale të tjera.

Të martën, më 13 shkurt, u mbajt konferenca mbi ecurinë e çështjes gjyqësore të përbashkët kundër Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe Haxhi Shalës. Gjatë konferencës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi disa urdhra gojorë, ndër të cilët edhe urdhra në lidhje me financimin e mbrojtësve të të akuzuarve. Pasi dëgjoi Mbrojtjen dhe Prokurorinë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi Zyrën Administrative të DHSK-së që të kontaktojë urgjentisht Ministrinë e Drejtësisë së Kosovës për të marrë sqarime në lidhje me këtë aspekt dhe të raportojë deri më 20 shkurt 2024.

Konferenca e ardhshme mbi ecurinë e çështjes do të caktohet në mars.

Më 8 shkurt, Trupi Gjykues në çështjen gjyqësore *Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi* refuzoi të shqyrtonte themelësinë e kërkesës së një viktime për pjesëmarrje në proces, për të cilën konstatoi se nuk u dorëzua në kohë. Në çështjen *Thaçi dhe të tjerët* janë pranuar mbi 140 viktima për të marrë pjesë në proces.

Më 9 shkurt, Trupi Gjykues në të njëjtën çështje gjyqësore lëshoi vendim në lidhje me masat e paraburgimit të vendosura në dhjetor për tre të akuzuar: Hashim Thaçin, Kadri Veselin dhe Rexhep Selimin.

Për informacion: më 1 dhjetor 2023, Trupi Gjykues vendosi disa kufizime mbi vizitat dhe komunikimet e këtyre tre të paraburgosurve me qëllim mbrojtjen e dëshmitarëve, pasi Prokuroria paraqiti transkripte në të cilat dukej se të akuzuarit u treguan vizitorëve për dëshmi konfidenciale të dëshmitarëve të mbrojtur.





Megjithatë, si pjesë e vendimit në dhjetor, Gjykatësit vendosën që të mos përcaktonin kufizime për “vizitat private”, që do të thotë se vizitat speciale me bashkëshortet ose partneret dhe/ose fëmijët e të paraburgosurve do të kryhen jashtë rrezes së shikimit dhe dëgjimit të oficerëve të paraburgimit.

Në vendimin e 9 shkurtit, Trupi Gjykses shqyrtoi informacion nga Zyra Administrative në lidhje me raste të tjera të nxjerrjes së informacionit konfidencial gjatë vizitave dhe u shpreh se “në të paktën dy raste, z. Selimi u përmendi dy palëve të paautorizuara informacion konfidencial në lidhje me dy dëshmitarë të mbrojtur, çka përbën nxjerrje të informacionit konfidencial. Po kështu, z. Thaçi u përmendi informacion konfidencial dy anëtarëve të familjes së tij, çka përbën nxjerrje të informacionit konfidencial”. Megjithatë, Trupi Gjykses përsëri nuk vendosi kufizime për vizitat private me bashkëshortet ose partneret dhe fëmijët.

Megjithëse Trupi Gjykses nuk vendosi kufizime për vizitat private, gjykatësit theksuan se “kur [...] Administratorja (ose shefi i Paraburgimit) ka informacion se ekziston rrezik i besueshëm që të zbulohet informacion gjatë një vizite, përfshirë gjatë një vizite private, Administratorja, (ose shefi i Paraburgimit që vepron në emër të saj) ka kompetencë të refuzojë vizitën dhe/ose të caktojë masa që janë proporcionale dhe të domosdoshme për trajtimin me efektivitet të rrezikut.

Gjykatësit gjithashtu u tërhoqën vërejtje të akuzuarve dhe Mbrojtjes që të mos zbulojnë informacion konfidencial, përfshirë dëshmi të dëshmitarëve të mbrojtur, gjatë vizitave në objektin e paraburgimit.

Gjykatësit përsëritën gjithashtu se një i paraburgosur mund të kundërshtojë para Trupit Gjykses çdo vendim të Administratores për refuzimin ose vendosjen e kufizimeve për një vizitë private specifike.

Më 14 shkurt në të njëjtën çështje gjyqësore, Trupi Gjykses miratoi tërheqjen e Gregori Kihou si kryembrojtës i Hashim Thaçit, që hyn në fuqi ditën kur Administratorja e DHS-së cakton kryembrojtësin e ri për të përfaqësuar z. Thaçi.

Lidhur me një aspekt tjetër që ka të bëjë me mbrojtësit: pasi ka marrë kërkesën e Venkatesvari Alagendrës në lidhje me emërimin e saj të mundshëm si mbrojtëse e Salih Mustafës, Trupi Gjykses në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët*, më 8 shkurt konstatoi se mund të lindë konflikt interesi nëse ajo përfaqëson Salih Mustafën krahas pozitës aktuale si mbrojtëse e Jakup Krasniqit. Megjithatë, Trupi Gjykses thekson se ky vendim nuk duhet të kuptohet si shprehje e mendimit të Trupit Gjykses mbi emërimin ose jo të znj. Alagendra si mbrojtëse e z. Mustafës, sepse për këto aspekte vendos Administratorja.

Seanca e ardhshme në çështjen *Thaçi dhe të tjerët* është caktuar për të martën, 20 shkurt, në orën 09:00.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

